



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9 Qershor 2021

Nr. 401

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kërkesës nr. 1376 prot., datë 15.04.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë ndaj bashkisë Korçë, bashkisë Pustec, DPGJC, zyrës së legalizimeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme

**Kërkues:** Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Ilir Meta

**Ndaj:** Bashkisë Korçë, bashkisë Pustec, DPGJC, zyrës së legalizimeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme

**Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata e KQZ-së gjatë shqyrtimit administrativ,

**VËREN:**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1376 prot., datë 15.04.2021, është depozituar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkesa me lëndë: “Kërkohet nisja e hetimeve dhe verifikimeve mbi vjedhjen e identitetit dhe të dhënave personale të qytetarëve Shqiptarë”.



Data: 9 Qershor 2021  
Nr. 401

Për shqyrtimin administrativ të kërkesës nr. 1376 prot., datë 15.04.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë ndaj bashkisë Korçë, bashkisë Pustec, DPGJC, zyrës së legalizimeve në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Referuar kërkesës, pretendohet se: *“Nga të dhënat e siguruar dhe atyre të bëra publike rezulton se në qarkun e Korçës, në disa bashki që janë të banuara nga komuniteti i pakicës kombëtare maqedonase, evidentohet se ka ndodhur një fenomen, ku shtetas me rekorde kriminale të shpallur në kërkim ndërkombëtar apo të përfshirë në veprimtari të paligjshme, janë pajisur me pasaportë dhe dokumente identifikimi nga autoritetet vendore atje, jo me të dhënat e tyre por duke përdorur të dhënat e identitetit të personave të tjerë të cilët nuk kanë probleme me ligjin. Pas pajisjes nga shteti shqiptar me dokumente identifikimi, kanë vijuar më pas ndjekjen e procedurave edhe pranë shtetit të Maqedonisë së Veriut nga ku për shkak të mbajtjes së dyshetësisë së personit që i është vjedhur identiteti janë pajisur edhe atje me dokumente identifikimi dhe kanë vijuar me lëvizjen e lirë për t’u fshehur autoriteteve të ndjekjes policore, apo të zbatimit të ligjit ndërkombëtar”*.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht faktin nëse është apo jo organi publik kompetent, për shqyrtimin e tyre.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këtë kërkesë të depozituar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i cila ka si objekt elementë të disa veprave penale si: “Veprimet që lehtësojnë trafikimin”, “Falsifikim i dokumentave”, “Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”, “Falsifikim i akteve të gjendjes civile”, “Shpërdorim i detyrës”,



“Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga ana e tij, pikërisht për shkak të mungesës së kompetencës së këtij organi për shqyrtimin e tyre.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se kërkesa është jashtë kompetencës së tij lëndore dhe nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ, për këtë kërkesë të depozituar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

### **V E N D O S:**

1. Të shpallë moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesës.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

